



**Republika e Shqipërisë**  
**Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar**  
**Asambleja Mbarëkombëtare e Misionarëve të Pajtimit**  
**PLEQËSIA E LARTË**

Adresarr. Maliq Muça, Pall 46 ap 23. Email: gjin\_marku@yahoo.com, tel: 0693238786 / 0682737989  
Web: [www.pajtimi.com](http://www.pajtimi.com)

PROT NR 1/10

ME 26 TETOR 2024

**PARASHTRIME**

**Para institucioneve të shtetit shqiptar, Presidentit, Kuvendit të Shqipërisë, Gjykatës Kushtetuese dhe Organeve të Drejtësisë.**

**PËR PRISHJEN E MONOPOLIT**

**Mbi politikën, pasuritë kombëtare dhe tregun**

**PËR NJOHJE E BASHKËPUNIM**

**Parlamentit dhe Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës, Senatit dhe Komisionit të Sigurisë së kongresit të SHBA-së, Këshillit të NATO-s, Departamentit të Shtetit të SHBA-së, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**

**Qëllimi: Mbrojtja e Shqiptarëve, ndalimi i shfrytëzimit skllavërues, heqja e monopolit mbi politikën, pasuritë kombëtare e tregun**

**Paragrafi I**

**MONOPOLI KA RRËNUAR DEMOKRACINË DHE KULTURËN E LIGJIT, KA SJELLË PËR SHUMË VITE MUNGESËN E DREJTËSISË ME PASOJA SHKATËRRIMTARE PËR VENDIN DHE JETËN E QYTETARËVE.**

Pavarësisht anëtarësimit në NATO dhe hapave drejt integrimit në BE, gjendja e sotme ekonomike e shoqërore e shumicës së shqiptarëve është shumë e rëndë si pasojë e korruptionit e mosfunkcionimit të institucioneve të shtetit. Partnerët e Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian janë të vendosur të mbrojnë funksionimin e shtetit të së drejtës dhe këmbëgulin për vendosjen e drejtësisë por abandonohen nga politika. Shoqëria shqiptare vuan për shkak të monoplit mbi politikën, pasuritë kombëtare dhe tregun. 60 % e qytetarëve mbahen prej 35 vitesh vetëm nga emigracioni sepse korruzioni në të gjitha nivelet e qeverisjes, në administratën qendrore e lokale, ka lënë në gjendje të papranueshme pagën dhe pensionet. Shqiptarët trajtohen si skllevër nga një grup politikanësh e biznesmenësh që kanë bërë monopol politikën e shtetit. Monopoli mbi politikën ka krijuar monopolin mbi shtetin, tregun e pasuritë kombëtare, ka minuar demokracinë dhe shtetin e së drejtës, ka



dhunuar shoqerinë dhe dinjitetin e njeriut, ka sjellë korrupsionin si kulturë, plaçkitjen e pronave e parave të publikut, depresionin në shoqëri, dhunën në familje dhe krimin e organizuar, konfliktet, vrasjet, vetvrasjet e braktisjen e vendit nga shumica e qytetarëve. Partitë politike shqiptare në perceptimin e opinionit publik janë bërë organizatat më të sofistikuara ku gjajnë strehë individë e grupe të krimit të organizuar për vjedhjen e buxhetit të shtetit e pronave publike. Në luftën për pushtet ato janë shndërruar disa herë në organizime të dhunëshme mbi institucionet duke nxitur dhe lufthën civile por asnjëherë nuk janë gjykuar për veprimtaritë e tyre kriminale.

### Paragrafi i Dytë

#### STATUSI JURIDIK I PARASHTRIMEVE

Parashtrimet bëhen nga Pleqësia e Lartë nën statusin juridik të Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar u themelua në vitin 1990 nga akademikët dhe intelektualët më në zë të kohës me qëllim parandalimin e konflikteve që lindën bashkë me pluralizmin politik në Shqipëri. Komiteti ka synuar ruajtjen e paqes, vëllazërisë fetare e barazisë gjinore si dhe integrimin e shoqërisë shqiptare në Bashkimin Evropian. Themelimi i këtij komiteti gjeti mbështetjen e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, z. Perez De Kuelar, dhe Departamentit Amerikan të Shtetit që në vitin 1990. Në vitin 2002, amabasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Z. Xheims Xhefri (James Jaffry), i rikonfirmoi qeverisë shqiptare se Departamenti Amerikan i Shtetit mbështet Komitetin e Pajtimit Mbarëkombëtar dhe strategjinë e tij për aplikimin e traditës në mbështetje të shtetit të së drejtës. Ky bashkëpunim u thellua nga Kryetarja e Dhomës së Kongresit të ShBA-së, zonja Nenci Pelozi (Nancy Pelosi), në vitin 2008, e cila shprehu interesimin për raportin e Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar mbi ngjarjen tragjike të Gérdecit dhe marrëveshjen e fshehtë politike në Tiranë, për t'i përcjellë atë Komisionit të Sigurisë së Kongresit të SHBA-së. Kanë bashkëpunuar me Komitetin e Pajtimit Mbarëkombëtar, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Prokuroria pranë Gjykatës së Hagës, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i OKB-Së, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës, Parlamenti Evropian, Zyra e Komisionit Evropian dhe OSBE-së. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për ndalimin e luftës civile në vitin 1997 që nxitej nga liderësi politik. Misionarët e pajtimit ndaluan vajtjen e djemve nga veriu i shqipërisë në jug për të luftuar kundër protestuesve, ndërsa në krye të Komitetit të Shpëtimit Publik, në qarkun e Lushnjës, populli zgjodhi përfaqësuesin e Kryesisë së Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar, z. Pasho Uruçi, që ndaloi çdo lloj konfrontimi mes qytetarëve dhe mbrojti policinë e institucionet nga sulmet e organizuara.

### Paragrafi i Tretë

#### DETYRIMI I KOMUNITETIT NDËRKOMBËTAR NDAJ SAKRIFICËS SË POPULLIT SHQIPTAR PËR PAQEN.

Këto parashtrime bëhen mbas konkluzioneve të nxjerra nga ekspedita dy vjeçare e misionarëve të pajtimit, Prill 2022- Maj 2024, e cila punoi në terren për promovimin e kulturës së ligjit dhe shtetit të së drejtës. Parashtrimet konçidojnë me 80 vjetorin e fitores evropiane mbi nazizmin i cili solli tragjedinë më të madhe të njerëzimit në luftën e dytë botërore. Kjo fitore e rreshtoi popullin shqiptar në krah të Aleancës Perëndimore



për lirinë dhe shtetin e së drejtës. Në lidhje me këtë fakt, Pleqësia e Lartë e Pajtimit Mbarëkombëtar rikonfirmon qëndrimin e saj se sakrifica e të rënëve në luftën e dytë botërore dhe dita e fitores mbi nazizmin duhet të bashkojë popullin shqiptar në rrugën e lirisë e demokracisë dhe të mos përdoret nga politika si përcarje midis shqiptarëve. Pleqësia e lartë e Pajtimit Mbarëkombëtar sjell në vëmendje të Komunitetit Ndërkombëtar se tragjeditë e luftës së parë e të dytë botërore erdhën si pasojë e padrejtësive që po luheshin në kurriz të popujve, veçanërisht të shqiptarëve. Pleqësia e Lartë e Pajtimit Mbarëkombëtar i drejtohet Komunitetit Ndërkombëtar që të marrë parasyshë detyrimin që ka ndaj sakrificës së popullit shqiptar të cilin e ndanë në pesë shtete për interesat e disa fuqive të mëdha. Është detyrë e këtij Komunitetit Ndërkombëtar të vlerësojnë sakrificën e këtij kombi që asnjëherë në histori nuk ka cënuar territoret e finqnjëve apo paqen në Evropë. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar i ka kërkuar Bashkimit Evropian të shohë me përparësi mundësinë e kompensimit të dëmit me anë të financimeve në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe mjedis në të gjitha shtetet që kanë marrë territore shqiptare, sepse kështu do të përfitojnë edhe popujt e tjerë të rajonit. Dëmi i shkaktuar prej më se një shekulli ndaj shqiptarëve është qindra miliarda dollarë dhe asnjëherë nuk është shqyrta as nga politika e brendëshme shqiptare as nga Komuniteti Ndërkombëtar. Komuniteti Ndërkombëtar duhet të ulë shpenzimet për luftrat e ti kthejnë ato në investime për paqen sepse asnjë fitore me luftë nuk sjell paqe. Pleqësia e Pajtimit Mbarëkombëtar është kundër çdo qëndrimi që nxit urrejtje, nacionalizëm, apo ndryshime kufijsh në Evropën e Bashkuar, por kërkon qëndrim të drejtë të Bashkimit Evropian që shqiptarët tëjenë të barabartë me popujt e tjerë të Evropës. Shqiptarët u sakrifikan për paqen e Evropës prandaj është detyrë e Evropës dhe e ish fuqive të mëdha ta vlerësojnë këtë sakrificë.

#### Paragrafi i Katërt

#### POLITIKA DHE SHTETI DUHET TË KENË NË THEMEL TRADITËN, VIRTYTIN, MORALIN E DREJTËSINË.

Shqiptarët në shekullin e 20 janë konsideruar si popull jo shtet formues kur ata trashëgonin modelin më të mirë të shteti të së drejtës. Ata e kishin themeluar shtetin e tyre të së drejtës 800 vjet përpara Evropës si mjet paqeje e shërbimi të bazuar mbi virtytin, moralin e drejtësinë duke transmetuar një shembull unikal të kulturës së ligjit. Arbërit nuk e pranan asnjëherë që shteti të jetë mjet dhune. Arbërit e rregulluan jetën me kodet e tyre etike që nuk lidheshin me fenë, ideologjinë a ligjet e pushtuesve, por vetëm me të drejtën duke treguar se Mbretërimi i së Drejtës sjell Mbretërimin e Paqes dhe lumturinë për qytetarët. Shteti i Arbërit u themelua në Mirditë, por u përhap në të gjithë Arbërinë si zakon e kulturë e ligjit duke ruajtur gjuhën, zakonet e identitetin kombëtar. Shteti i Arbërit udhëhoqi Mirditën për 800 vjet pa ushtri, polici e burgje, pa taksa e protesta, por vetëm me ndërgjegje e drejtësi. Ai organizim e mbrojti lirinë dhe nevojën e e qytetarëve për një jetë të sigurtë, në paqe e thjeshtësi, në harmoni me natyrën dhe mjedisin, pa iu nënshtruar instiktit dhe egos për sundim e pasurim të padrjtë. Prijësit e arbërve u shquan për thjeshtësinë e barazinë me qytetarët, ndërgjegjen e pastër si dhe përgjegjësinë e lartë për popullin. Shteti udhëhiqej sipas ligjeve dhe kodeve të përcaktuara nga kuvendet demokratike e pleqësia ku merrnin pjesë edhe vegjëlia. Liderët dhe pleqësia shërbyen pa asnjë përfitim dhe mbetën gjithë jetën të barabartë me qytetarët. Përfitimi i pasurisë nga prijësi dhe anëtari i pleqësisë



IRAJA  
ALBANIA

dënohej rëndë, me djegien apo sekuetrimin e pronës si dhe lecitjen. Natyra e mjedisit i shqiptarëve është e përcaktuar si "MIRAJA E Paprekëshme" "E ADHURUESHMË" që asnjieri nuk mund ta keq-përdorte sepse ishte "E MIRA E PËRBASHKËT". Drejtësia dhe e drejta janë zbatuar në mënyrë të barabartë për secilin qytetar pa dallim feje, gjinie, prejardhje, apo pozite shoqërore. Shteti i Arbërit hyn në tre mrekullitë e njerëzimit. Azia krenohet me Budën, (mrekullia e filozofisë dhe meditimit), Finlanda krenohet me Baba Natalen, (mrekullia e ëndrrës dhe dashurisë së miliarda fëmijëve), ndërsa shqiptarët krenohen me shtetin e tyre unikal të së drejtës, Shtetin e Arbërit, ëndrra e përherëshme e njerëzimit.

#### Paragrafi i Pestë

#### SITUATA NË SHQIPËRI ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME TRADITËN, SHTETIN E SË DREJTËS DHE KULTURËN E LIGJIT.

Nëse shqiptarët do ruanin traditën e tyre për shtetin e së drejtës nuk do përjetonin ngjarjen tragjike të rrëzimit të qeverisë së Vlorës e vrasjen e kryeministrat të parë, Ismail Qemalit, nuk do kishin një komision ndërkombetar për tu përcaktuar kufinjtë, nuk do kishin një lëvizje barbare si ajo e Haxhi Qamilit, nuk do përjetonin tradhëtitë e Esat Pashës e rrëzimin e shtetit demokratik të Fan Nolit, nuk do kishte braktisje të vendit nga Mbreti e lejimin e pushtimin nazi-fashisht të vendit, nuk do kishte izolim 50 vjeçar nga diktatura e as një tranzicion 35 vjeçar rrënuar të vlerave të njeriut, shoqërisë e pasurive të vendit. Në situatën e tanishme, për shkak të korruptionit, institucionet e shtetit shqiptar nuk gjeljnë autoritet në popull. Politika është bërë nocion i së keqes për qytetarët. Ligji dhe kushtetuta janë zhvlerësuar nga keqpërdorimi. Klasa politike edhe kur miraton ligje në përputhje me standartet evropiane nuk i zbaton ato dhe as i implementon në shoqëri. Ligji kryesor i lirisë e jetës mbi tokën e pronat, hipotekën dhe legalizimet, zvarritet e keqpërdoret prej 35 vitesh duke sjellë si pasojë vetëgjyqësinë, konfliktet e mijëra të vrarë për tokën e pronat. Çështjet gjyqësore zvarriten për shkak të korruptionit dhe mungesës së gjyqtarëve. Në të gjitha gjykata krijuhen stogje me dosje për mungesë gjyqtarësh e prokurorësh. Ato mund të shqyrtohen vetëm mbaš disa vitesh kur ka kaluar afati e vendimi nuk ka më dobi, as efekt. 40 % e qytetarëve nuk shkojnë në gjykata por kërkojnë zgjidhje nga pleqësia e Komitetit të Pajtimit Mbarëkombetar. Të gjitha vendimet e pleqësisë së pajtimit pranohen nga palët ndërsa vendimet e gjykatave kanë sjellë si pasojë 4200 të vrarë. Krimi i vjedhjes së parave të shtetit është kthyer në sistem që ushqen edhe krimet e tjera ekonomike ndaj pronës publike e mjedisit. Trafikimi i ligjeve në paralment ka krijuar monopolin mbi tregun, politikën e pasuritë e vendit. Klasa aktuale politike perceptohet në popull se punon vetëm në interes të sundimit e përfitimit personal të një grupei të ngushtë të lidhur me liderët politik e familjen e tij. Anëtarësia e partive politike e futur në administratë nuk është e ndërgjegjëshme për përgjegjësinë ndaj qytetarëve. Partitë politike që duhet të jenë aset i çmueshëm i kombit janë kthyer në grupime që nuk aspirojnë demokraci, drejtësinë e lumturinë e vendit, por interesin e ngushtë të sundimit në pushtet. Çdo qytetar shqiptar e ka shumë të vështirë të mendojë se mund të bëhet pjesë e zgjdhjes së problemeve me pjesmarrje në politikë apo me votën e tij sepse shteti dhe politika janë nën ndikimin negativ të një pakice të fuqizuar që kanë monopol partitë politike. Partitë politike kanë gjeneruar vazhdimisht urrejtjen mes qytetarëve, nxitjen e konfliktave dhe vrasjet.



## Paragrafi i Gjashtë

### MONOPOLI MBI POLITIKËN E TREGUN KA KRIJUAR VAZHDIMISHT MANIPULIMIN E VOTIMIT, SHITBLERJEN E VOTAVE DHE DEFORMIMIN E PROCESIT ELEKTORAL.

Pas 35 vjet tranzicion, mbi 50 % e votuesve nuk merr pjesë në votime, nuk përfaqësohet në parlament apo këshillat bashkiake sepse kanë parë se votat manipulohen nga stafet e partive politike që kanë monopolin. Partitë politike parlamentare, për të ruajtur monopolin, miratojnë ligje elektorale në favor të deputetëve të preferuar të liderit partiak nëpërmjet listave të myllura pa konkurrencë. Kjo gjë ka krijuar edhe monopolin mbi politikën e tregut. Rreth 200 000 djem e vajza, që kanë mbaruar me nivel të mirë arsimin e mesëm e të lartë, kanë emigruar jashtë vendit sepse tregu në Shqipëri është monopol i individëve të lidhur me qeverinë e partitë politike. Mediat nuk kanë mundur ta lëvizin shoqërinë përpara edhe pse kanë përparuar në llojshmëri e profesionalizëm. Një pjesë e tyre janë nën kontrollin e leadershipit politik që ka monopolin dhe i financon ato. Inteligjencia shqiptare e afirmuar për nivelin e saj të lartë në shkallë botërore vazhdon të mbetet e zhgënjer dhe pa interes për të punuar në Shqipëri. Partitë politike aktuale kanë korruptuar krerët e lëvizjeve sindikaliste që duhet të kundërshtojnë monopolin mbi tregut. Forumet e grave dhe të rindërtimit në këto parti korruptohen nga lideri i partisë ku aderojnë dhe keqpërdoren. Tregu i të gjitha llojeve të produktit vendas po falimenton, jo vetëm nga monopolii, por dhe nga konkurenca e mallrave të importuara që kanë lidhje me përfaqësuesit e monopolit në treg. Fatkeqësisht, komuniteti ndërkombëtar nuk i ka analizuar me objektivitet partitë politike shqiptare, të cilat nuk kanë mision, nuk udhëhiqen nga parime demokratike dhe nuk reformohen brenda tyre. Komuniteti ndërkombëtar duhet të mbështesë kontrollin e publikut dhe të institucioneve të drejtësisë mbi veprimtarinë e kundraligjëshme të partive politike e leadershipit të tyre dhe të ndihmojë për hetimin e të gjithë individëve të inkriminuar në organet e zgjedhura ligjvënëse e ligjzbatusse, pa përjashtim, deri tek drejtuesit e lartë të partive politike, të qeverisë e të shtetit. Monopoli mbi politikën dhe qeverisjen e vendit ka ngritur zyra formale auditit brenda dikastereve me punonjës që emërohen nga ministri ose drejtuesi i dikasterit me qëllim mbulimin e abuzimeve e vjedhjeve. Ato i kanë shërbyer deri tani fshehjes së korruptionit e vjedhjes së parave të buxhetit nëpërmjet raporteve audituese që kontrollohen nga ministri ose drejtuesi i dikasterit. Populli është me drejtësinë dhe kërkon ndëshkimin e krimit deri në nëvelet e larta, por kjo kërkesë e popullit abandonohet nga përfaqësuesit e partive politike që punojnë kundër reformave dhe drejtësisë.

## Paragrafi i VII-të

### PARTITË POLITIKE DUHET TË MBAJNË PËRGJEGJËSI PARA LIGJIT PËR DËMET NDAJ SHTETIT DHE SHOQËRISË.

Partitë politike kanë detyrimin kushtetues të mbrojnë demokracinë dhe shtetin e së drejtës, buxhetin e shtetit që është mundi, djersa dhe gjaku i fëmijëve të popullit, të ngrenë ekonominë e mirëqenien e gjithë qytetarëve dhe të garantojnë lumturinë e tyre, por kanë vepruar në kundërshtim me këtë detyrë. Ato e kanë shkelur me vullnet të plotë besimin e popullit dhe nuk i vret ndërgjegja për këtë, sepse kanë bërë ligje e vendime për të mos marrë përgjegjësi por për të përforcuar pozitën e tyre sundue. Në Kuvendin e Shqipërisë ka parti që janë shitur e blerë nga individë që kërkojnë për tu



*LBALIA*

pasuruar nëpërmjet prezencës në qeveri. Partitë politike nuk janë hetuar e gjykuar deri tani si çdo organizatë tjeter, person juridik apo fizik edhe pse duhet të gjykohen, të dënohen e të dalin jashtë ligjit kur nuk përbushin detyrën, kur përfshihen në veprimtarinë e plaçkitjes së buxhetit të shtetit e të pasurive kombëtare, në mashtrimet elektorale e trafikimin e ligjeve, në vendime të qeverisë apo këshillave bashkiake të korruptuara. Ato nuk janë gjykuar asnjë herë për këto vendime as dhunën ndaj institucioneve e vrasjen e qytetarëve në luftën për marrjen apo mbajtjen e pushtetit. Nëpërmjet prezencës dhe vendim-marrjes në parlament partitë politike kanë mbajtur nën presion e nën kontroll drejtësinë. Reforma në drejtësi, e mbështetur nga partnerët kryesorë të Shqipërisë, SHBA e BE, ka zgjuar shpresën tek qytetarët, por organet e reja të drejtësisë sulmohen në publik e mbrapa shpine nga përfaqësuesit e korruptuar politik. Reforma nuk është përbushur, nuk mbështetet me mjetet e duhura financiare, as me burimet njerëzore e infrastrukturën e kërkuar. Dretësia përsëri vazhdon të mbetet nën presionin e dy faktorëve rrënues, politikës dhe krimit të organizuar, që lashkëveprojnë kundër kësaj drejtësie.

#### Paragrafi i VIII-të

#### **MBI DISA REFORMA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE SI DOMOSDOSHMËRI E PRISHJES SË MONOPOLIT**

Plekësia e Lartë e Pajtimit Mbarëkombëtar fton Presidentin e Shqipërisë, Kuvendin e Shqipërisë, Qeverinë shqiptare dhe Gjykatën Kushtetuese që me vetë-iniciativë e bashkëpunim të reformojnë ligjin për partitë politike. Në ligj të përcaktohet qartë përgjegjësia e organizatës politike, e udhëheqësve të tyre dhe e deputetëve para ligjit për mashtrimet ndaj popullit, shpërdorimin e buxhetit të shtetit, vjedhjen e taksave dhe për të gjitha punët publike që janë paguar nga buxheti i shtetit e nuk janë kryer siç duhet. Të përcaktohet me ligj procedimi penal për të gjithë anëtarët e një vendimarrjeve korruptive të këshillit të ministrave, këshillave bashkiake etj. Përfaqësuesit e zgjedhur, deputetët e anëtarët e këshillave bashkiakë si dhe drejtuesit e shtetit të çdo niveli të mos kenë asnjë lloj imuniteti para ligjit për vendim-marrjet e tyre që bien në kundërshtim me interesin publik dhe favorizojnë monopolin. Të reformohet kodi penal që korruzioni e shpërdorimi i detyrës me pasojë vjedhjen e buxhetit të shtetit të dënohen sipas demit të shkatuar me dënimë maksimale jo më pak se 25 vite burgim dhe të përjashtohen nga parashkimi i veprës penale. Të rritet financimi e të sigurohen burimet njerëzore të organeve të reja në drejtësi. Zyrat e auditit, të cilat deri tani i shërbejnë më shumë justifikimit të abuzimit me buxhetin e shtetit se sa kontrollit, të shkëputen nga varësia e drejtuesve të dikastereve dhe ti kalojnë në shërbim Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK-ut. Të përcaktohet me ligj që të kalojë në shërbim të institucioneve të reja të drejtësisë Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Instituti i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive. Buxheti i zyrave të auditit, i kontrollit të lartë të shtetit dhe i Institutit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive është buxhet që deri sot ka qenë jo efikas dhe i ka shërbyer korruzionit, prandaj të vihet në shërbim të drejtësisë. Plekësia e Lartë e Pajtimit Mbarëkombëtar fton qeverinë dhe ligjvënësin të reformojnë dikasterin e Ministrisë së Drejtësisë. Drejtësia nuk mund të ketë ministër sepse si emërtim është në kundërshtim me parimin e drejtësisë. Drejtësia është e pavarrur dhe nuk ka ministër. Qeveria mund të ketë një agjenci të Shërbimeve ndaj Drejtësisë por jo të quajtur Ministria e Drejtësisë. Sipas modelit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës



**DANIA**  
Ministri i Drejtësisë njësohet me funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm, krejtësisht i pavarur nga qeveria. Është e nevoshme që në Shqipëri të miratohet me ligj veprimitaria e prokurorit privat për ti ardhur në ndihmë qytetarëve, zbulimit të krimave ndaj tyre dhe shtetit, zbulimin e korruptionit e krimit të organizuar, lidhjeve të krimit me politikën duke ruajtur fshehtësinë e denoncimeve. Të përgatitet e miratohet ligji për kontrollin e pasurive si dhe vetingun e politikanëve, të deputetëve dhe biznesménëve që përfitojnë nga tenderat me buxhet shtetëror. Të përgatitet e miratohet ligji për kontrollin e hetimin e shpenzimit të parave nga të gjitha tenderat dhe projektet e bëra deri tani me buxhetin e shtetit. Pasuritë e vëna me paratë e buxhetit të shtetit të sekuestrohen e ti kthehen shtetit e popullit. Vlerat monetare të sekuestruara tu kthehen qytetarëve nëpërmjet kompensimit të demit për çdo qytetar, rritjes së pensioneve e pagave të cilat duhet të ishin jo më pak se 500 Euro pensioni e 1000 Euro paga minimale, po të mos vidhej buxheti I shtetit.

#### Paraqrafi IX

#### PËR NDALIMIN E TERRORIZMIT DHE FONDAMENTALIZMIT NË TERRITORET SHQIPTARE

PLEQËSIA e lartë e Pajtimit mbarëkombëtar e themeluar për drejtësinë e paqen mes qytetarëve, për bashkëjetesën, barazinë gjinore dhe integrimin në Evropën e Bashkuar, shpreh indinjatën e thellë për vrasjet e qytetarëve të pafajshëm në Shqipëri e kudo në botë nga mungesa e shtetit të së drejtës, nga luftërat e terrorizmi. Në këtë moment të vështirë për gjithë njerëzimin, Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar sjell në vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar faktin që shqiptarët nuk mund të lejojnë që në territoret e tyre të praktikohet terrorizmi sepse kanë kultivuar e ruajtur prej shekujsh vlerat e vëllazërisë fetare, paqes, lirisë e dinjitetit njerëzor. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar ka theksuar vazhdimisht se terrorizmi e fondamentalizmi ushqehen nga ideologji barbare, ekstreme, të papranueshme nga popujt e botës. Besimtarët e çdo feje, kurrsesi, nuk mund të jenë shkak i lindjes së urrejtjes dhe këtij terrorizmi që po shfaqet mbi njerëzimin. Në territorin shqiptar janë shfaqur akte tragjike të dhunës që kulmuin në vitin 1997 duke lënë të vrarë mbi 3000 qytetarë, përfshirë gra e fëmijë të pafajshëm. Vrasjet për gjakmarrje e hakmarrje në këto 35 vite tranzicioni kanë kaluar shifrën e 15 000 viktimave. Më tragjiket mbeten dhuna e përditëshme në familje me vrasjet e grave e vajzave, të cilat nuk i përkasin kulturës sonë qytetare. Nga kultura e re e terroristit gratë e vajzat mbeten të kontrolluara nga burrat e djemtë në familje, të pabarabarta në shoqëri, vendim-marrje e biznes, në kundërshtim me traditën. Që nga Princesha Teutë, treqind vjet para Krishtit, e deri sot, gratë e vajzat shqiptare kanë gëzuar lirinë dhe të drejtat e barabarta me burrat pa iu nënshtruar patriarkalizmit apo dogmave të tjera që janë shfaqur gjatë tranzpcionit postkomunist. Gjatë pushtimit 500 vjeçar otoman kombi shqiptar ruajti me dashuri e përkushtim zakonet e kulturën për mbrojtjen e barazisë gjinore e vëllazërisë fetare por kjo kulturë është deformuar nga krimi i organizuar i trafikantëve të femrave, drogës e armëve që kontrollojnë tregun e mbajnë lidhje dhe me eksponentë të politikës. Historia dëshmon se çdo kohë e në të gjitha territorët shqiptare, nga qytetari i thjeshtë deri tek prijësit, si Ali Pashë Tepelena, Ismail Qemali e Ahmet Zogu, krijuan jetën e lumtur të burrave myslimanë me bashkëshorte të krishtera e anasjelltas, por sot shfaqen mijëra raste që vajzat shqiptare dhunohen nëse kanë lidhje dashurie me djem të fesë tjetër e anasjelltas. Kjo stuatë vjen si shkak i formacioneve radikale e rrymave që kanë deformuar dhe traditën zakonore. Komiteti i



Pajtimit Mbarëkombëtar i ka konsideruar vrasjet e shumta pas rënies së komunizmit si vrasje barbare e shkelje e të gjitha rregullave kanunore, por ka gjetur kundërvënien e grupeve radikale të krimit të organizuar e terrorizmit që organizojnë abandonimin e procesit të pajtimit duke kryer dhe vrasjen e fshehtë të prijesave e misionarëve të pajtimit nga viti 1997 deri në vitin 2012. Deformimi e keqinterpretimi i kanunit është vepër e terrorizmit dhe krimit të organizuar për të nxitur gjakmarrjen e ngujimet duke i predikuar ato si veprime kanunore. Përballë kësaj lufte të nëndheshme të terrorizmit, Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar ka punuar me përkushtim për përhapjen e kulturës së ligjit e promovimin e traditës në mbështetje të shtetit të së drejtës duke bërë të mundur ndalimin e mbi 60 % të vrasjeve. Nëse nuk do ishte Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar e misionarët e tij të pajtimit, që punojnë në mënyrë vullnetare në çdo fshat e qytet të vendit, sot do ishin mbi 100 000 viktima të vrasjeve barbare nga mentalitetit kanunor i deformuar. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar ka bashkëpunuar me shumë sukses me komunitetet fetare në shqipëri, veçanërisht me atë mysliman në procesin e pajtimit. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar ka theksuar se është fat për shqipérinë dhe shqiptarët egzistenca e Komunitetit Mysliman sepse myslimanizmi shqiptar ka spikatur për vlerat e tij paqësore para gjithë njerëzimit. Ai duhet të inkurajohet për tu bërë udhëheqësi botëror i Islamit, ashtu siç është bërë bektashizmi shqiptar, prandaj duhet të mbrohet jo vetëm nga populli e shteti shqiptar por edhe nga Bashkimi Evropian e Alenca e Paqes kundër terrorizmit. Pleqësia e Lartë e Pajtimit Mbarëkombëtar i kërkon Komunitetit Ndërkombëtar dhe qeverisë shqiptare të zbulojnë e dënojnë grupet kriminale e individët që punojnë për terrorizmin kundër procesit të pajtimit e prishjes së imazhit udhëheqësve të Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar me dizinformime e montazhe në internet.

#### PARAGRAFI X

##### APLIKIMI I TRADITËS NË MBËSHTETJE TË SHTETIT TË SË DREJTËS, DETYRË E INSTITUCIONEVE TË SHTETIT SHQIPTAR DHE BASHKIMIT EVROPIAN.

Europa dhe Shetet e Bashkuara të Amerikës i kanë ruajtur me përkushtim vlerat e traditës ligjore në mbështetje të shtetit të së drejtës. Në Shqipëri nuk është bërë sa duhet për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë për kulturën e ligjit dhe shtetit të së drejtës. Rregullat e ligji në demokracinë arbërore ishin të shenja sepse ishin të drejta. Ato shkruheshin në mure e pllaka guri në anë të rrugëve të Arbërisë për ti pasur në qendër të vemendjes. Për ruajtjen e kësaj vlere historike, në shekullin e 19, arkeologët austriakë i vendosën mbishkrimet e Stemën e Arbërit në muret e Kishës së Shën Marisë së Arbërit, në oborrin e së cilës u krijuua shteti i parë i së drejtës, pa ushtri, polici e burgje, por vetëm me ndërgjegje e drejtësi. Arbërit e Ilirisë edhe pse i përkisnin kulturës pagane e mirëpritën apostullin Pal, 40 vjet mbas vdekjes së Krishtit, kur ai u foli mbi sakrificën e fljimin e Jezu Krishtit dhe për qëndrimin e nënës së tij Maria, që përballë tiranisë e çdo torturë nuk e braktisi të birin. Arbërit e pranuan Shën Marinë si simbol i dashurisë dhe sakrificës së nënave, vajzave e bashkëshorteve të tyre duke i dhënë dritë e dimension hyjnor barazisë gjinore. Fatkeqësisht këto vlera të shtetit të së drejtës dhe Kisha e Shën Marisë së Arbërit janë lënë jashtë vemendjes e promovimit. Kisha e Arbërit është e vetmja kishë në Evropë që zhveshi vellon hyjnore e u bë pjesë e kuveneve qytetare. Kjo kishë i mbështeti arbërit nën pushtimet shekullore për të ruajtur shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, gjuhën, territorin, bashkëjetesën dhe rregullin në



komunitet, pa iu nënshtuar sundimit. Në historinë e njerëzimit asnjë institucin fetar në botë nuk ka mundur të luajë ndonjë rol për shtetin e së drejtës, të barazisë dhe virthytit sjë dhe vëllazërimin mes feve, siç e bëri kjo kishë kur derdhesin lumenj gjaku midis kombesh me fe të ndryshme. Fatkeqësisht ky rol dhe kjo kishë janë lënë në hije. Gjithë perëndimi e lindja islame dhuruan donacione për rimëkëmbjen e Kishës së Shën Marisë së Parisit, e shquar nga luksi si mijra tempuj të tjerë, që nuk luajti ndonjë rol as mori përsipër misionin e Kishës së Shën Marisë së Arbërit, e thirrur si Kisha e Gjithë Njerëzimit. Në vitin 1993 kryeministri Aleksandër Meksi e vizitoi këtë Kishë dhe u interesua për restaurimin e saj sëbashku me muzeun e arbërit, por projekti nuk u realizua as është ndjekur nga deputetët e zonës apo kryebashkiakët e Mirditës. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, krahas pajtimit të familjeve në hasmëri, ka organizuar vazhdimisht takime kombëtare e ndërkontakte përmes mbrojtjen e promovimin e kulturës së ligjit dhe trashëgimisë së arbërvë në mbështetje të shtetit të së drejtës. Në vitin 2014, me rastin e 800 vjetorit të Shtetit të Arbërit, ky komitet zhvilloi në Tiranë takim shkencor mbi Arbërinë si Tempull i së Drejtës. Akademikët e huaj propozuan që në mjeshterin natyror të Kryeqendrës së Arbërit të thirret Konferenca Ndërkontakte: Mbi Mbretërimin e së Drejtës përmes mbrojtjen e Paqes dhe Jetës së Njerëzimit. Konferenca u bë realitet me 9 dhe 10 tetor 2023, me pjesmarrjen e 22 studjuesve të huaj dhe 40 akademikëve shqiptarë. Në konferencë u kërkua që:

- 1- Data 25 maj e çdo viti të jetë Dita e Takimit me Demokracinë, Paqeji dhe Lumturinë e Shtetit të Arbërit, ku të ftohen përmes bashkëbisedim udhëheqësit politikë, përfaqësuesit e shtetit, të trupit diplomatik, deputetë, gjyqtarë, prokurorë, studentë dhe qytetarë të vendeve të ndryshme të botës.
- 2- E Diela e Parë e Tetorit, që përkon me ditën e Shën Marisë së Arbërit, të shpallet Festë Mbarëkombëtare përmes shqiptarët e Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të Zi e Kosovës.
- 3- Qeveria Shqiptare të restaurojë Kishën e Shën Marisë së Arbërit, të ngrejë muzeun në 5 dhomat shtesë të saj të ndërtuara përmes këtë qëllim që në vitin 1993, me kontributet e kishave perëndimore si dhe të sistemojë sheshin para saj.
- 4- Qeveria të riparojë me thëmel rrugën kombëtare që të çon tek kjo Kishë e cila është një nga rrugët më atraktive përmes turistëve dhe rrugë dytësore strategjike e NATOS.

Për kërkesat e mësipërme në këto parashtrime dhe të kësaj Konference ndërkontakte shprehim besimin e angazhimit të institucioneve shqiptare dhe Komunitetit Ndërkontakte përmes mirësimin e situatës dhe integrimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Selim Abazi      Preng Cara      Mexhit Hoxha      Nur Gjoni      Vitore Doda  
 Pashk Paluca      Mynyr Hoxha      Zef P. Cara

**PLEQËSIA E LARTË**  
**PËR KOMITETIN E PAJTIMIT MBARËKOMBËTAR**



Gjin Marku  
 Kryetar  
 Sali Gera  
 Sekretar i Përgjithshëm

